



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ZeroLine" Sh.P.K. të datës 01.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konkurs projektimi për hartimin e projektit kryesor të nënkalimit në pikëtakimin e rrugës magjistrale M2 me rrugën A - lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-22- 14679-4-1-3 dhe nr. të brendshëm 616 22 215 413, Komuna e Prishtinës (AK) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ZeroLine" Sh.P.K. e datës 01.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konkurs projektimi për hartimin e projektit kryesor të nënkalimit në pikëtakimin e rrugës magjistrale M2 me rrugën A - lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-22- 14679-4-1-3 dhe nr. të brendshëm 616 22 215 413.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i dt. 29.05.2023.
- III. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "ZeroLine" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "ZeroLine" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 01.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 29.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Konkurs projektimi për hartimin e projektit kryesor të nënkalimit në pikëtakimin e rrugës magjistrale M2 me rrugën A - lagjen Kalabria" me nr. të prokurimit 616-22- 14679-4-1-3 dhe nr. të brendshëm 616 22 215 413.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se parashtruesi është eliminuar nga ky konkurs i projektimit për shkak se në fazën e parë parashtruesi nuk është vlerësuar me mbi 70 poena sipas nenit 55 par. 55.28 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP") lidhur me nenin 23.1 - Vlerësimi i Koncept Projekteve sipas FDT (Fletës së të Dhënave të Tenderit) ku thuhet se "Pikët Totale për kritere janë 100, ndërsa pragu minimal 70 pikë për të kaluar në fazën e II-te (hapja e zarfave të kandidatve)".

Bazuar në nenin 59 par. 59.1 të RRPP është përcaktuar se "kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagese, nga cilado palë e interesuar". Sa i përket nocionit "palë e interesuar" sipas nenit 4 par. 1 nën par. 26 të LPP është përcaktuar se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar".

Lidhur me kërkesën për rishqyrtim të parashtruesit fillimisht duhet cekur se ky aktivitet i prokurimit zhvillohet si procedurë mbi konkursin për projektim përmes dorëzimit fizik (me dy zarfe). Sipas nenit 46 par. 46.3 të RRPP është përcaktuar se "Qasja me dy zarfe nënkupton se Operatorët ekonomik dorëzojnë dy zarfe të mbyllura në të njëjtën kohë, njëra përmban Propozimin Teknik dhe tjetra përmban Propozimin Financiar të dyja të futura në nja zarf të vetëm të jashtëm". Tutje përmes nenit 55 paragrafit 55.16 RRPP është përcaktuar se "Të dy zarfet, që përmbajnë "Projektimin Ideor" dhe "Dokumentacionin e Kandidatit", pastaj do të mbyllet në një zarf të jashtëm të shënuar me: a. Adresën e vendit për dorëzim të konkurseve për projektim; b. Numrin e Prokurimit; dhe c. Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit".

Hapja dhe vlerësimi i projekteve është rregulluar përmes nenit 55 të RRPP ku ndër të tjera përcaktohet se:

"55.24 Pasi që identiteti i pjesëmarrësve nuk do t'i shpaloset jurisë, zyrtari përgjegjës i prokurimit do t'i hap zarfet e pranuar me kohë dhe do t'i ndajë zarfet që përmbajnë "projektet ideore" nga ato që përmbajnë "dokumentacionin e kandidatit".

55.25 Zyrtari i prokurimit do t'ia transferojë jurisë vetëm zarfet që përmbajnë "projektet ideore" sipas nenit 80 të LPP-së. Zarfet që përmbajnë "Dokumentacionin e Kandidatit" do të mbahen të pahapura nga zyrtari përgjegjës i prokurimit të depozituara në një vend të sigurt.

55.26 Juria do ta organizojë procesin e vlerësimit në atë mënyrë që të sigurohet integriteti dhe paañësia e procedurës. Juria do t'i vlerësojë projektimet vetëm në bazë të kriterëve të shënuara (pikët e peshës të shënuara në Dosjen e Konkursit të Projektimit).

55.27 Juria do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të arritur një vendim me konsensus.

55.28 Nëse nuk mund të arrihet një vendim me konsensus, secili anëtar i jurisë do ta vlerësojë veçmas secilin projekt ideor dhe do të jep pikë (rezultat) për projektin ideor bazuar në kriteret e shënuara në dosjen e konkursit për projektim. Pikët përfundimtare për secilin projekt ideor realizohen duke i mbledhur pikët nga të gjithë anëtarët e jurisë dhe duke i pjesëtuar me numrin e anëtarëve të jurisë. Propozimi ideor që arrin rezultatin më të lartë në pikë radhitet i pari dhe projekti i dytë më pikë radhitet i dyti e kështu me radhë.

55.29 Substanca e vendimmarrjes së jurisë dhe mendimeve të anëtarëve individual të jurisë do të mbahen konfidenciale nga të gjithë anëtarët e jurisë. Vlerësimi i jurisë dhe radhitja përfundimtare e projekteve do të regjistrohet duke përdorur formularin standard. Lista radhitëse e projekteve e krijuar nga juria pastaj do t'i dorëzohet Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit.

55.30 Pasi që Zyrtari i Prokurimit pranon listën e radhitjes së projekteve, Zyrtari i Prokurimit, duhet që të përgatitë Formularin B58 "Njoftimin mbi vendimin e AK" dhe ta publikoj në platformë të prokurimit elektronik, pret skadinin e intervalit, gjatë të cilit ofertuesit mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit dhe me pas dhe krijon një komision vlerësues për vlerësimin e përshtatshmerise së Kandidatit.

55.31 Në rast të një procedure që shpie në shpërblimet me para, projekti që radhitet i pari, dhe që pranohet si i përgjegjshëm, do të jetë projekti fitues".

Lidhur me pretendimet e parashtruesit, duhet cekur se pjesa e pretendimit ku thuhet se AK ka bërë shkelje të LPP dhe të rregulloreve për prokurim publik, kjo pjesë e pretendimit nuk qëndron për faktin që komisioni për vlerësimin e ofertave i përbërë prej 7 ekspertëve profesional ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tendereve duke u bazuar çdo herë në LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi për prokurim publik.

Komisioni për vlerësimin e ofertave ka qenë komision i formuar prej ekspertëve profesional dhe në mënyrë të përpikët ka bërë vlerësimin dhe kontrollimin e ofertave të dërguara nga ana e OE.

AK ka bërë vlerësimin e ofertave me një juri prej 7 ekspertëve profesional, ku vlerësimi i ofertave është bërë gjithnjë duke u mbështetur në LPP dhe në Rregulloren për Prokurim Publik, duke respektuar Parimet e Përgjithshme të LPP, nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti si dhe nenin 7 të LPP.

Shkelje e nenit 7 të LPP, do të ishte nëse do të veprohej ndryshe dhe në dëm të OE të cilët kanë arritur që të jenë të përgjegjshëm dhe kanë dëshmuar se kanë plotësuar të gjitha kriteret e parashtruara në Dosje të Tenderit. Sa i përket barazisë në trajtim dhe jo diskriminimit, duhet theksuar sërish se AK ka trajtuar të gjithë OE në mënyrë të barabartë dhe duke parë se çfardo vlerësimi tjetër që do të bënte për ndonjë OE do të ishte i padrejtë për OE tjetër.

Me fjalë të tjera nuk ka dorëzuar asnjë provë apo dëshmi me të cilën do të mund të konfirmohej një pretendim i tillë. Prandaj autoriteti kontraktues në mungesë të argumenteve dhe provave nuk ka se si t'i falë besimin këtij pretendimi.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP lidhur me nenin 59 të RRPP. Në anën tjetër parashtruesi në kërkesën për rishqyrtim nuk ka paraqitur dëshmi apo argumente të qëndrueshme për të vërtetuar se është palë e interesit në këtë rast apo për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I, II dhe III të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën IV dhe V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 09.06.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.